

Miratohet projekti i restaurimit të Shpellës me Piktura në Finiq



Shpella me Piktura në fshatin Kostar, Mesopotam Finiq, pjesë e fondit të trashëgimisë shpirtërore, tashmë do të restaurohet, pas miratimit të projektit për këtë “xhevahir” që mban statusin e monument kulture i kategorisë së parë.

Lajmin e ka bërë publik ministrja e Kulturës Elva Margariti e cila e cilëson një lajm të mirë.

“Shpëtohet një tjetër thesar i trashëgimisë sonë kulturore. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale miratoi projektin e restaurimit në Shpellën me Piktura në fshatin Kostar, Mesopotam, Finiq. Me të gjitha faqet e pikturuara, kisha, monument kulture i kategorisë I, ndodhet në anën veriore të fshatit Kostar, ndërtuar në fund të shek. XVIII, në faqen e malit, mbështetur në një gur shkëmbor”, u shpreh Margariti.

Ky objekt është i rëndësishëm edhe për banorët e zonës pasi aty kryhen ende kryhen rituale, shërbesa dhe ceremoni.